



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. Prot. 3665

Tiranë, më 4.07.2017

LËNDA: Lidhur me raportin e Task-Forcës për procesin zgjedhor

DREJTUAR: SH.T.Z. BERND BORCHARDT
AMBASADOR I PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI

SH.T.Z. PETER TEJLER
KREU I MISIONIT TË ODIHR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE
NË SHQIPËRI

Z. CLAUD NEUKIRCH
DREJTUES I ZYRËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS NË TIRANË

ZNJ. ANA KADOVIC
PËRFAQËSUES I PROGRAMIT NDI NË SHQIPËRI

Të nderuar Shkëlqesi,

Fillimisht më lejoni t'ju shpreh në emër të Task-Forcës për zgjedhjet falenderimet për pjesëmarrjen e përfaqësuesve tuaj në mbledhjet e saj dhe interesimin tuaj lidhur me problematikën e zgjedhjeve.

Në kuptim të pikës 29, të VKM 473/2017, Task-Forca ushtron funksionet dhe përmbush detyrat e saj deri në përfundimin e procesit zgjedhor.

Me përfundimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2017, zyra e Zëvendëskryeministrit është duke përgatitur një raport të hollësishëm përshkrues dhe analizues lidhur me problematikën e konstatuar gjatë fushatës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

Sapo të jetë gati kemi kënaqësinë që raportin në fjalë së bashku me gjetjet dhe rekomandimet t'jua vëmë në dispozicion me qëllim informimin tuaj në funksion të misionit që përmbushin organizatat që ju drejtoni.

Duke ju falënderuar për mbështetjen tuaj, më lejoni t'ju shpreh konsideratën time më të lartë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

LEDINA MANDIJA

